



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA

KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



N.SH. "TV ISTOGU CHANEL"

Numri i biznesit - 71169685

Pronar – Luard MEHMETAJ

OSHMA "TV ISTOGU CHANEL"

Rr/Ibrahim Rugova

Istog

Ref:1802/151/LIC/ni

VENDIM

për licencimin e Ofruesit të Shërbimeve Mediale Adiovizuale "TV ISTOGU CHANEL" për transmetim përmes operatorëve të shpërndarjes – me seli në Istog

Faktet

1. Komisioni i Pavarur për Media (KPM), në bazë të nenit 3, paragrafi 2.6. të ligjit për KPM (Ligji nr. 04/L-44), nxjerr akte nënligjore për rregullimin e transmetimit dhe të shërbimeve mediale audiovizuale, të cilat nevojiten për të kryer funksionet e saj në pajtim me standardet ndërkombëtare.
2. Rregullorja për Ofruesit e Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale KPM-2017/02, ka hyrë në fuqi më 25 janar 2017, ndërsa, me Kreun III të kësaj rregulloreje, KPM ka krijuar bazën ligjore për licencimin e Ofruesve të Shërbimeve Audio dhe Audiovizuale të cilët transmetojnë përmes operatorëve të shpërndarjes, e që do të kenë mundësi të prodhojnë programe përmbajtësore dhe t'i transmetojnë ato përmes cilit do operator të shpërndarjes.
3. Më datën 19 prill 2018, kandidati "TV ISTOGU CHANEL", ka parashtruar aplikacionin për licencë të KPM-së për të vepruar si ofrues të shërbimeve mediale audiovizuale (OSHMA) për transmetim përmes operatorit të shpërndarjes.

Arsyetim

4. Komisioni vlerëson se, kandidati për licencë të KPM-së OSHMA "TV ISTOGU CHANEL", në aplikacionin e tij ka paraqitur të dhënat e nevojshme për Licencë të KPM-së dhe në pajtueshmëri me Kreun III të Rregullores KPM-2017/02.

5. Komisioni vlerëson se kandidati për licencë të KPM-së “TV ISTOGU CHANEL” ka ofruar të dhënat e mjaftueshme për vlerësim të aplikacionit. Materialet e ofruara si pjesë e aplikacionit konsiderohen të qëndrueshme sa i përket skemës programore në përgjithësi; të dhënat rreth aftësive profesionale dhe menaxheriale për të udhëhequr me ofrues të shërbimeve mediale audiovizuale, përfshirë edhe të dhënat rreth qëndrueshmërisë financiare.
6. Sipas Nenit 21, paragrafit 5 të Rregullores KPM-2017/02, kandidati për licencë të KPM-së për ofrues të shërbimeve mediale audivizuale “TV ISTOGU CHANEL”, duhet të veprojë në pajtueshmëri me të gjitha rregullat dhe aktet tjera nënligjore të nxjerra nga KPM, në pajtueshmëri me Ligjin e KPM-së, si dhe me ligjet tjera të zbatueshme në Republikën e Kosovës.
7. Komisioni vlerëson se kandidati “TV ISTOGU CHANEL” ka përmbushur kriteret kualifikuese për t’u pajisur me licencë të KPM-së për ofrues të shërbimeve mediale audivizuale, në pajtim të plotë me Rregulloren e KPM-së KPM-2017/02.

Vendim

8. Komisionit merr vendim që, kandidatit “TV ISTOGU CHANEL”, me seli në Istog, t’i lëshoj licencën në afat prej dhjetë (10) vitesh, për të vepruar si Ofrues i Shërbimeve Mediale Audiovizuale përmes operatorëve të shpërndarjes, në Republikën e Kosovës.
9. OSHMA “TV ISTOGU CHANEL” mund të fillojë ofrimin e përmbatjeve programore, vetëm pas pagesës së parë të tarifës vjetore për licencë të KPM-së, dhe pas nënshkrimit të Pakos së Licencës.

Lëshimi i Vendimit

10. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.



Muja FERATI

Kryetar

KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE



09.07.2018

datë